

MENDIM PARALEL

1. Unë Firdes Shuli, në cilësinë e anëtares së trupës që ka kryer procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Vitjuna Terpollari (Mata), në kushtet kur vota ime ka qenë e domosdoshme gjatë procesit të vendimmarrjes, kam votuar *pro* konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit Vitjuna Terpollari (Mata), propozuar nga relatori i çështjes në përfundim të procesit. Por, ndaj mendim ndryshe nga shumica sa i takon pozitës së znj. Mata, duke qenë e mendimit që ajo nuk është subjekt rivlerësimi, në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, sipas meje, procesi duhet të ndërpritej pa një vendim përfundimtar.

2. Sikurse ka rezultuar, znj. Vitjuna Terpollari (Mata), në fillim të hetimit administrativ, në datën 24.7.2020, me anë të postës elektronike ka paraqitur një kërkesë drejtuar Komisionit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit ndaj saj, me arsyetimin se nuk është subjekt i ligjit nr. 84/2016. Komisioni, në datën 14.10.2022, me anë të postës elektronike njoftoi subjektin e rivlerësimit se me shumicë votash ka vendosur mospranimin e kërkesës dhe vijimin e procesit të rivlerësimit.

3. Paraprakisht, unë si anëtare që kam votuar pro pranimit të kërkesës së subjektit, sjell në vëmendje se:

- Në vitin 2013, znj. Vitjuna Terpollari Mata është kualifikuar për të ndjekur programin 3-vjeçar të formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, në profilin “prokuror” për periudhën 2013 – 2016.

- Pas përfundimit të vitit të dytë të formimit fillestar, në vitin 2015, në bazë të nenit 23 të ligjit nr. 8737/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i shfuqizuar, dhe të nenit 19 të ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar/shfuqizuar, me Dekretin e Presidentit të Republikës Nr. 9220, datë 7.9.2015, znj. Vitjuna Terpollari (Mata) është emëruar prokurore në stazh aktiv (magjistrate kandidate) në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën shtator 2015 – tetor 2016.

- Pas kryerjes së stazhit profesional në këtë Prokurori, që përkon me përfundimin e programit 3-vjeçar të formimit fillestar, dhe pas vlerësimit të kryer nga Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës, referuar ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar/shfuqizuar, me Dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë Nr. 9758, datë 11.10.2016, znj. Vitjuna Terpollari (Mata) është emëruar në detyrë prokurore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, funksion që e ushtron edhe aktualisht.

- Emërimi i saj në detyrën e prokurores është bërë mbi propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm të datës 10.10.2016.

4. Sot, me zhvillimin e jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, përmes vendimit nr. 39, datë 25.10.2022, i pari që shprehet mbi pozitën juridike të kategorisë së magjistratëve të periudhës 2013 – 2016, unë ndaj qëndrim të ndryshëm nga shumica sa i takon pozitës së znj. Vitjuna Terpollari (Mata), e cila është një prej tyre, duke vlerësuar se:

Së pari, znj. Terpollari (Mata) nuk e ka pasur statusin e magjistratit në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016 dhe të ligjit nr. 84/2016, pasi e ka fituar atë pas hyrjes në fuqi të tyre

e, në këto kushte, ajo nuk përfshihet në kategorinë e subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Së dyti, znj. Terpollari (Mata) është bërë pjesë e sistemit të drejtësisë, me emërimin në detyrë përmes Dekretit të Presidentit të Republikës, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese e, si e tillë, duhet t'i nënshtrohej kontrollit sipas juridiksionit të përgjithshëm, në zbatim të ligjit nr. 96/2016.

Për të arritur në këtë vlerësim i referohem dispozitave ligjore si vijojnë:

5. Hyrja në fuqi e ligjit nr. 76/2016, i cili miratoi ndryshimet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në datën 11.8.2016, e gjeti znj. Terpollari (Mata) në përfundim të periudhës së stazhit profesional, që përfaqësonte edhe vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës.

6. Në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 14 të tij përcaktohet se: *“Formimi fillestar i kandidatëve përfshin një periudhë trevjeçare që përbëhet nga: “a) Një vit program teorik me lëndë të ndryshme të së drejtës; b) një vit praktikë nën kujdesin e një pedagogu të shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari apo prokurori me kualifikim të lartë; c) një vit praktik me ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuar nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori (periudha e stazhit profesional)”*. Po ashtu, ky ligj në nenin 19 të tij përcakton se: *“Në përfundim të periudhës së parashikuar në shkronjën “b” të nenit 14 të ligjit, sipas vlerësimit të bërë nga këshilli pedagogjik i shkollës, kandidatët për magistratë, sipas profileve të caktuara, caktohen përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë dhe prokurorë nga Presidenti i Republikës, me propozimin, përkatësisht të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm”*. Ndërsa, më tej, në nenin 20 të ligjit përcaktohet se: *“Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve bëhet nga këshilli pedagogjik, në bazë të rezultateve teorike dhe praktike të stazhit...”*.

7. Nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme, por edhe atyre të ligjit nr. 8136/1996, individët që ndjekin studimet në këtë shkollë janë të titulluar si “kandidatë për magistratë”. Dispozitat e tij (nga neni 1-21 i tij) e lidhin fitimin e këtij titulli me emërimin e tyre, duke bërë një dallim të qartë mes statusit të tyre si “kandidatë për magistratë” deri në fund të stazhit profesional, dhe “magjistratë” vetëm pas emërimit sipas kritereve ligjore të mirëpërcaktuara, që kryhet pas mbarimit të këtij stazhi, në përfundim të studimeve të plota në këtë shkollë.

8. Në të njëjtën linjë janë edhe dispozitat e ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili në nenin 17 përcakton se: *“Emërohet prokuror në njërin nga prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, personi i cili ndër të tjerash ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës”*. Ndërsa në nenin 23 të po këtij ligji parashikohet se: *“Me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, Presidenti i Republikës emëron prokurorë në stazh personat që kanë mbaruar vitin e 2-të të Shkollës së Magjistraturës, për të kryer stazhin profesional, të parashikuar në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë në prokuroritë pranë gjykatave që kanë kushtet më të mira për organizimin e këtij stazhi”*. Pas përfundimit të stazhit profesional, Presidenti i Republikës dekreton caktimin e tyre në prokuroritë sipas nevojave që kanë këto të fundit”

9. Pra, në të gjitha dispozitat e mësipërme, vërehet dallimi ligjor mes dy kategorive, të emëruarve në detyrë si “prokurorë” dhe atyre të emëruar në stazhin profesional si “prokurorë në stazh”.

10. Pas shfuqizimit të ligjit nr. 8136/1996 dhe nr. 8737/2001, me miratimin e paketës ligjore që shoqëroi ndryshimet kushtetuese, ligji nr. 96/2016 i konsideron të kualifikuarit/studentët që ndjekin Shkollën e Magjistraturës si “kandidatë për magistrat” dhe në nenin 33 të tij

parashikon rregullat për praktikën/stazhin profesional, si për kandidatët gjyqtarë ashtu edhe për prokurorë. Sipas nenit 34 të ligjit, ata konsiderohen sërish si “kandidatë magjistratë” edhe pasi janë diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe marrin titullin “magjistrat” vetëm pas emërimit të tyre.

11. Ne analizë të sa më sipër, momenti i emërimit të znj. Terpollari (Mata) si prokurore me Dekretin e Presidentit të Republikës në datën 11.10.2016, është edhe momenti kur ajo ka fituar statusin e magjistratit.

12. Ndryshimet kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016 hynë në fuqi në muajin gusht të vitit 2016. Subjekti Vitjuna Terpollari (Mata) ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës në periudhën tetor 2013 – qershor 2016. Me anë të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 9220, datë 7.9.2015 është caktuar për të kryer praktikën profesionale si studente e Shkollës së Magjistraturës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën shtator 2015 – tetor 2016. Ndërsa, me Dekret të Presidentit të Republikës nr. 9758, datë 11.10.2016, është emëruar prokurore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

13. Sikurse vërehet, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, në gusht të vitit 2016, znj. Vitjuna Terpollari (Mata) ka qenë prokurore në stazh dhe nuk e kishte fituar statusin e magjistratit/prokuratorit, por gëzonte vetëm statusin e kandidatit për magjistrat, rrethanë e cila, nuk i jep asaj, në vlerësimin tim, titullin e prokurores në kuptim të parashikimit ligjor të nenit 179/b të Aneksit të Kushtetutës. Ushtrimi i kufizuar i funksioneve të prokuratorit prej kandidatëve për magjistratë përgjatë periudhës së stazhit ka qenë një detyrim që vinte prej qenies së tyre si kandidatë në Shkollën e Magjistraturës e, për më tepër, si një praktikë (me ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuar nën drejtimin e një gjyqtari ose prokuratorit, periudha e stazhit profesional), e përvetësimit të njohurive të duhura për t’u diplomuar dhe marrë titullin e magjistratit. Moskryerja në mënyrën e duhur të detyrave të prokuratorit stazhier përgjatë kësaj periudhe mund të ndëshkohej në kuptim të ligjit me një vlerësim negativ të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës, me pasojë mosdiplomimin e tyre.

14. Veç sa më sipër, neni 160 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përcaktuar qartë modalitetet e trajtimit të grupit të magjistratëve të diplomuar në vitin 2016 të cilësuar specifikisht si “kandidatë për magjistratë” dhe jo “prokurore në detyrë”, duke ndihmuar në interpretimin logjik që i bëhet nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, si dhe ka referuar edhe dispozitat që duhen zbatuar për kontrollin e tyre para emërimit në detyrë, pjesa III, kreu II dhe III i ligjit nr. 96/2016. Sipas nenit 160, pika 2 e ligjit nr. 96/2016: *“Deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm do të vazhdojë të ushtrojë kompetencat e mëposhtme, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj: a) emëron magjistratët kandidatë të diplomuar në vitin 2016, në përputhje me pjesën III, kreu II, të këtij ligji, të paktën dy muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji; b) merr vendim për caktimin në pozicione të kandidatëve magjistratë të diplomuar në vitin 2016, sipas pjesës III, kreu III, të këtij ligji, brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji”.*

15. Fakti që znj. Terpollari (Mata) ka depozituar deklaratat sipas shtojcave të ligjit nr. 84/2016, sikurse shumica arsyeton, në vlerësimin tim, nuk mund të afektojë interpretimin që i bëhet nenit 179/b të Kushtetutës, interpretim i cili lidhet me vullnetin e ligjvënësit dhe jo me sjelljen procedurale të subjekteve. Nga ana tjetër, çmoj se znj. Terpollari (Mata), ashtu sikurse të diplomuarit e tjerë të së njëjtës periudhë, në kushtet e një paqartësie ligjore në lidhje me statusin e tyre, ka marrë masat me plotësimin e deklaratave, pikërisht për të shmangur një ndëshkim, veçanërisht në kohën e dorëzimit të deklaratave, por jo vetëm.

16. Bazuar në sa më sipër, në vlerësimin tim, në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit në vendimin nr. 39, datë 25.10.2022, Komisioni ka vepruar në tejkalim të juridiksionit të tij rivlerësues nëpërmjet procesit të rivlerësimit të znj. Terpollari (Mata) dhe sipas nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative duhet të dispononte me ndërprerjen e procesit pa një vendim përfundimtar.

ANËTARE E TRUPËS
Firdes Shuli